

Ziraat Bankası

RAPORT VJETOR 2021 I MENAXHMENTIT TË VENDIT NË KOSOVË

PRISHTINË, 2022

PËRMBAJTJA

1. RRETH RAPORTIT VJETOR	5
2. MENAXHMENTI I VENDIT NË KOSOVË	5
3. VIZIONI – MISIONI – STRATEGJITË	6
4. INDIKATORËT KRYESOR	7
5. VLERËSIMI I MENAXHMENTIT TË VENDIT	7
6. QASJA NDAJ QËNDRUESHMËRISË	8
7. INDIKATORËT MAKROEKONOMIK	8
8. BURIMET NJERËZORE	9
9. AUDITIMI I BRENDSHËM, PAJTUESHMËRIA, AML	9
10. MENAXHIMI I RISKUT	10
11. PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2021 DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	11

1. RRETH RAPORTIT VJETOR

Fushëveprimi i Raportit

Ky raport vjetor është përgatitur për të adresuar performancën e Menaxhmentit të Vendit të Ziraat Bankës në Kosovë për periudhën nga 1 janari 2021 deri më 31 dhjetor 2021. Të dhënat e mbledhura për qëllimin e këtij raporti përbëjnë kritere standarde matëse për raportet vjetore që do të publikohen nga Menaxhmenti në të ardhmen. Raporti publikohet çdo vit dhe gjithashtu parashikohet të raportohet në baza vjetore edhe në vitet në vijim.

2. MENAXHMENTI I VENDIT NË KOSOVË

2.1 AFATI KOHOR I MENAXHMENTIT TË VENDIT NË KOSOVË



T.C. Ziraat Bankasi A.Ş si një bankë lider në Turqi ka zgjeruar aktivitetin e saj bankar në tregun e Kosovës duke hapur degën e saj të parë në Prishtinë, kryeqytet i Kosovës, më 8 qershor 2015. Për më tepër, me themelimin e Degëve të saj në Prizren dhe Pejë në vitin 2018, dhe më pas Degën në Ferizaj në vitin 2019, numri i degëve në vend është rritur në katër. Të katër degët janë të ndërlidhura me Menaxhmentin e Vendit në Kosovë, gjë që është krijuar/themeluar më 12 dhjetor 2019.

Që nga themelimi i saj për më shumë se shtatë vite më parë, T.C Ziraat Bankasi A.S - Dega në Kosovë ka synuar të arrijë një ndikim të qëndrueshëm tek klientët dhe mjedisi përmes operacioneve të saj të përgjithshme. Qasja jonë është duke dëshmuar mbështetje për zhvillimin ekonomik përmes financimit të klientëve dhe projekteve me ndikim të lartë në ekonominë e përgjithshme të vendit.

2.1 DEGËT E MENAXHMENTIT TË VENDIT NË KOSOVË

Në vitin 2021, Dega në Prishtinë së bashku me Menaxhmentin e Vendit është vendosur në ndërtesën trekatëshe me qasje të përshtatshme në Pejton në qendër të qytetit të Prishtinës. Kati i parë shërben si Dega në Prishtinë, ndërsa dy katet e tjera shfrytëzohen si objekt i Menaxhmentit të Vendit.

Dega në Prizren gjendet gjithashtu në një pjesë shumë të qasshme në qendër të qytetit. Operacionet dhe shërbimet me para të gatshme ofrohen në katin përdhës të ndërtesës dykatëshe në Prizren, ndërsa shërbimet për marrëdhënie me Klientët dhe menaxheri i Degës gjenden në katin e dytë.

Dega në Pejë ka ndërtesën e saj në qendër të qytetit të Pejës, duke ofruar shërbime për klientët tanë që nga viti 2018, duke poseduar një objekt me një kat përdhës.

Dega e fundit e themeluar në Kosovë, Dega në Ferizaj, ka një ndërtesë dykatëshe në njërën prej rrugëve kryesore të qendrës së Ferizajt. Ka të njëjtin koncept sikurse Dega në Prizren,

kati i parë ofron shërbime të parave të gatshme dhe të operacioneve për klientët tanë, ndërsa kati i dytë ofron shërbime për marrëdhënie me klientët dhe aty gjendet zyra e menaxherit të Degës.

3. VIZIONI – MISIONI – STRATEGJITË

Vizioni Ynë:

Të jemi një bankë që është universale, e respektuar dhe që ka një vlerë të lartë në treg; një bankë që ofron shërbime të gjera, të besueshme kudo në Turqi dhe në botë me të njëjtën cilësi, dhe e cila i plotëson nevojat e çdo segmenti; një bankë që i sheh burimet njerëzore si pasurinë e saj më të vlefshme; një bankë që vazhdimisht bën ndryshime dhe krijon vlerë në atë mënyrë që të përshtatet me të kaluarën e saj të rrënjësuar thellë; një bankë që premtan më shumë nga një bankë në çdo fazë dhe shërben si model për konkurrencën e saj.


Misioni Ynë:

Të jemi një bankë që i kupton nevojat dhe pritshmëritë e klientëve, duke u ofruar atyre kështu zgjidhjet më të mira dhe rekomandimet me vlerë nga kanali më i përshtatshëm; një bankë që sjell në çdo segment të shoqërisë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh në mënyrën më të shpejtë, më efektive përmes rrjetit të saj të gjerë të degëve dhe kanaleve alternative të shpërndarjes; një bankë që operon me përfitim dhe produktivitet sipas standardeve botërore duke njohur vlerat e saj etike dhe përgjegjësinë sociale; një bankë që e konsideron kënaqësinë e klientit si më të rëndësishme se çdo gjë tjetër.

Strategjitë Tona:

- Politika selektive të huadhënies kreditë dhe përdorimi efektiv i burimeve,
- Ofrimi i zgjidhjeve dixhitale për klientët,
- Rritja e vazhdueshme e përvojës së punonjësve dhe efikasitetit organizativ duke përmirësuar vazhdimisht mënyrën e të bërit biznes dhe duke investuar në zhvillimin profesional të punonjësve të saj.
- Maksimizimi i kënaqësisë së klientëve duke prodhuar zgjidhje të integruara financiare në të gjitha vendet ku operon Grupi Ziraat Finance,
- Duke marrë pjesë në tregtinë ndërkombëtare të Kosovës me Turqinë dhe Botën,
- Ofrimi i shërbimeve për klientët në çdo kohë dhe në çdo platformë, në kuadër të modeleve të shërbimit të së ardhmes.
- Integrimi i parimeve të menaxhimit të riskut mjedisor dhe social në modelin e biznesit.

4. INDIKATORËT KRYESOR



(EUR)	2020	2021	%
Paraja dhe Ekuivalentet e Parasë	851,147	672,884	-20.94%
Letrat me Vlerë	6,841,413	6,985,799	2.11%
Kreditë në Para të Gatshme	56,639,140	66,303,069	17.06%
Depozitat e Klientëve	56,239,040	69,150,171	22.96%
Depozitat e Tjera	8,654,027	13,500,281	56.00%
Kapitali	8,888,038	9,481,822	6.68%
Të Hyrat nga Interesi	2,991,101	3,895,490	30.24%
Shpenzimet e Interesit	1,042,118	1,481,522	42.16%
Fitimi Neto	1,018,318	593,784	-41.69%
Gjithsejtë Asete	79,672,232	95,195,977	19.48%

5. VLERËSIMI I MENAXHMENTIT TË VENDIT

Viti i kaluar ishte viti i rimëkëmbjes për ekonominë e Kosovës dhe u konsiderua si një vit i suksesshëm për sektorin e përgjithshëm bankar të Kosovës. Pavarësisht ndikimit të pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2021, Kosova ka pasur një rritje reale të PBB-së prej 10.5 për qind, që konsiderohet një rritje shumë e rëndësishme ekonomike. Zhvillimet pozitive të aktiviteteve ekonomike u reflektuan në lehtësimin gradual të masave pandemike, politikat mbështetëse të qeverisë, si dhe hyrjen rekord të remitancave nga diaspora në vlerë prej 1.14 miliardë euro.

Këto zhvillime pozitive në ekonominë e përgjithshme, u reflektuan edhe në T.C Ziraat Bankasi A.S - Dega në Kosovë për të pasur performancë të qëndrueshme financiare dhe klientët tonë të jenë të kënaqur me mbështetjen e bankës. Ne i kemi monitoruar nga afër klientët tanë dhe i kemi identifikuar zgjidhjet më të përshtatshme të financimit për ta, për t'ju mundësuar që të rikuperojnë nga ndikimet negative të shkaktuara nga pandemia. Duke

vepruar sipas kësaj qasjeje, T.C Ziraat Bankasi A.S. - Dega në Kosovë, rriti kreditë e saj për klientët për 17% në 66,303,069 milionë euro krahasuar me vitin 2020 ku totali i kredive ishte 56,639,140 €, e cila ishte e rëndësishme për t'i ndihmuar klientët tanë të tejkalojnë problemet e tyre financiare për shkak të kushteve pandemike. Depozitat e klientëve tanë u rritën gjithashtu 23% duke arritur në 69.150.171 € krahasuar me vitin 2020 ku depozitat ishin 56,239,040 €

Ne kemi prezantuar gjithashtu një ofertë dixhitale për klientët tanë ku përmes e-bankingut atyre i është ofruar mundësia për të hapur llogari online, gjë që promovoj më tej mbështetjen tonë për ta. Ne kemi qenë gjithashtu të fokusuar në shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve tanë duke krijuar kushte për të punuar nga shtëpia.

Prandaj, në emër të Menaxhmentit të T.C Ziraat Bankasi Dega A.S - Dega në Kosovë, dëshiroj të falënderoj të gjithë punonjësit tanë për punën dhe përkushtimin e tyre që i ka mundësuar degës sonë në Kosovë ta mbyll vitin financiar 2021 me trend pozitiv.

6. QASJA NDAJ QËNDRUESHMËRISË

Si ofrues i shërbimeve financiare, Ziraat Banka është e vendosur për të krijuar dhe mbajtur një qasje të qëndrueshme dhe proaktive ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe barazisë sociale.

- Si një bankë e fortë, udhëheqëse dhe e besueshme, ne jemi të përkushtuar për të maksimizuar strategjinë tonë të qëndrueshmërisë dhe të rrisim ndikimin tonë pozitiv në adresimin e sfidave afatgjata mjedisore dhe sociale.
- Çështjet mjedisore dhe sociale dhe rreziqet e tyre të mundshme trajtohen me një qasje të kujdesshme dhe të përpiktë në proceset e vendimmarrjes, menaxhimit e burimeve dhe infrastrukturës së shërbimeve. Qëndrueshmëria mjedisore dhe sociale njihet si një pikë e rëndësishme e agjendës, duke përfshirë ndryshimet klimatike dhe kalimin në një ekonomi me karbon të ulët.
- Si një punëdhënëse, Banka beson në rëndësinë e kushteve të punës të orientuara drejt njerëzve. Në modelin e biznesit, rëndësi i kushtohet krijimit të një strukture organizative që mëson duke ofruar mundësi të barabarta dhe mundësi vetëzhvillimi për të gjithë punonjësit. Rritja e motivimit të punonjësve dhe besnikërisë ndaj korporatës nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të praktikave të burimeve njerëzore është një nga objektivat kryesore të bankës.
- Qëllimi i bankës është të ruajë nivelet e larta të kënaqësisë dhe besnikërisë së klientëve duke përmirësuar vazhdimisht proceset e saj dhe duke ofruar produkte dhe shërbime bankare për të gjithë klientët e saj në formate praktike, të kuptueshme dhe të qasshme.

7. INDIKATORËT MAKROEKONOMIK

Ekonomia e Kosovës ka shënuar një rimëkëmbje të konsiderueshme gjatë vitit 2021, pas efekteve të rënda të pandemisë Covid-19 që ka karakterizuar vitin 2020. Ekonomia e Kosovës është rritur për 10.5 përqind në vitin 2021 por kjo rritje pritet të ngadalësohet në vitin 2022 kryesisht për shkak të rritjes më të ulët të kërkesës së brendshme dhe rritjes së deficitit neto të eksportit. Presionet globale të inflacionit vazhdojnë të pengojnë rimëkëmbjen. Ndërsa norma e inflacionit për çmimet e konsumit në vitin 2020 ka qenë 0.2%, në vitin 2021 është realizuar në 6.7%.

Në vitin 2021 Kosova ka importuar mallra në vlerë prej 4.684.198.000 EUR, ndërsa ka eksportuar 755.726.000 EUR. Megjithëse deficitin e bilancit tregtar është rritur në - 3.928.472.000 EUR, përqindja e mbulimit është përmirësuar nga 14.4% në 16.10%.

8. BURIMET NJERËZORE

Degët e Menaxhmentit të Vendit në Kosovë përbëhen nga 31 punonjës, prej të cilëve 16 punojnë në Degë, ndërsa 15 prej tyre punojnë në Menaxhmentin e Vendit të Degës (selisë). Personeli i bankës përbëhet nga banorë vendas me njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe asaj turke. Sipas gjinisë, 17 janë meshkuj dhe 14 femra. Sipas moshës, 1 anëtarë i stafit është nën 30 vjeç, 19 anëtarë të stafit janë nga 30 deri në 40 vjeç dhe 11 anëtarë të stafit janë nga moshë 40 deri në 50 vjeç.

9. AUDITIMI I BRENDSHËM, PAJTUESHMËRIA, AML

9.1 AUDITIMI I BRENDSHËM

Bordi i Drejtorëve i Bankës ka krijuar Funksionin e Auditimit të Brendshëm si një linjë të tretë të mbrojtjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili mbikëqyret nga Komiteti i Auditimit të Bankës. Funksioni i Auditimit të Brendshëm ofron një vlerësim të pavarur të përshtatshmërisë dhe pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e institucionit si dhe me rregulloret rregullatore. Si një funksion i pavarur, Auditimi i Brendshëm i raporton Komitetit të Auditimit të Bankës përmes departamentit përkatës në Zyrën Qendrore - Turqi. Gjatë vitit 2021 në bazë të planit vjetor të miratuar të auditimit, funksioni i auditimit të brendshëm ka përpiluar 9 raporte auditimi të proceseve të ndryshme të cilat i janë prezantuar Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit të Bankës.

9.2 PAJTUESHMËRIA

Krijimi i një funksioni efektiv të Pajtueshmërisë dhe Programi të Pajtueshmërisë është bërë një domosdoshmëri për të mbrojtur çdo organizatë shumë të rregulluar. Banka jonë është e përkushtuar të ruajë integritetin dhe reputacionin e saj duke siguruar mirëkuptim dhe pajtueshmëri të rreptë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si ato në nivel lokal ashtu edhe në nivel të grupit.

Në thelbin e tij, një Program efektiv i Pajtueshmërisë mbron një organizatë duke zbuluar dhe parandaluar sjelljen e pahijshme dhe duke promovuar respektimin e detyrimeve ligjore dhe etike të organizatës.

Funksioni i pajtueshmërisë në Bankë është një funksion i pavarur që i raporton Komitetit të Auditimit të bankës përmes departamentit përkatës të Zyrës Qendrore në Turqi. Funksioni i pajtueshmërisë është përgjegjës për të siguruar që korniza e pajtueshmërisë në bankë është e dizajnuar në mënyrën e duhur për të siguruar identifikimin dhe zbutjen e riskut të pajtueshmërisë, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin. Ky funksion është përgjegjës për të këshilluar dhe ndihmuar menaxhmentin ekzekutiv në lidhje me çdo risk të pajtueshmërisë, për të informuar atë mbi zhvillimet rregullatore, zbatimin dhe ndikimin në industrinë bankare. Për rrjedhojë, jep rekomandime se si të përmirësohet pajtueshmëria me kërkesat rregullatore dhe se si të shmangen rreziqet e pajtueshmërisë ndaj të cilave banka mund të ekspozohet.

9.3 AML

Luftimi i krimit financiar dhe pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme kombëtare dhe ndërkombëtare është jetike për të siguruar stabilitetin e Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S - Dega në Kosovë. Një mjedis i fuqishëm dhe efektiv i kontrollit të brendshëm dhe një infrastrukturë adekuate (që përfshin njerëzit, politikat dhe procedurat, testimet e kontrolleve dhe sistemet e TI-së) janë të nevojshme për të siguruar që ne e zhvillojmë afarizmin tonë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe pritshmëritë mbikëqyrëse të lidhura.

Proceset dhe kontrollet tona Kundër Pastrimit të Parave (AML) dhe Njihni Klientin Tuaj (KYC) synojnë të parandalojnë keqpërdorimin e produkteve dhe shërbimeve tona për të kryer krime financiare. Banka kërkon vazhdimisht për të rritur efikasitetin e mjedisit tonë të kontrollit të brendshëm dhe për të përmirësuar infrastrukturën tonë. Gjatë vitit 2021, Departamenti i AML-së ka rishikuar rregullat që përcaktojnë vlerësimin (notimin) e riskut të klientit dhe kontrollet e brendshme të integruara brenda Modulit të AML-së, i cili ofron një ekzaminim gjithëpërfshirës dhe identifikimin e saktë të aktiviteteve të dyshimta, duke i mundësuar bankës të monitorojë dhe identifikojë rastet e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në baza të vazhdueshme. Ndër të tjera, Banka është e fokusuar në rishikimin e informacionit të klientit me qëllim që të ketë informacion të saktë për profilin e klientit i cili i mundëson bankës të kuptojë klientët e saj dhe afarizmin e tyre financiar, për ti shërbyer ata më mirë dhe për të menaxhuar me maturi rreziqet e saj.

10. MENAXHIMI I RISKUT

Departamenti i Menaxhimit të Riskut i Menaxhmentit të Vendit në Kosovë të Ziraat Bankës siguron që ekziston një sistem adekuat dhe efektiv i menaxhimit të riskut për të identifikuar, përcaktuar sasinë, rishikuar, vlerësuar dhe matur riskun në përputhje me pajtueshmërinë rregullatore dhe kërkesat e auditimit, tolerancën e miratuar ndaj riskut, oreksin e riskut dhe planet strategjike të miratuara nga Banka.

Duke filluar nga janari i vitit 2020, Banka ka zbatuar modelin SNRF 9 për llogaritjen e HPK-së (humbja e pritshme kreditore).

Në përputhje me objektivin e bankës për rritjen e portfolios kreditore, banka ka parashikuar një rritje të provizioneve në raport me rritjen e portfolios, ndërsa për disa sektorë janë parashikuar provizione më konservative.

Bazuar në progresin aktual, sipas parashikimeve tona viti 2021 do të duhej të mbyllet duke llogaritur provizionet me rreth 2% të totalit të portfolios kreditore (kreditë dhe garancitë, bankat dhe letrat me vlerë), ndërkohë që sipas parashikimeve tona, me rritjen e portfolios dhe trendit të vonesave deri në fund të vitit 2022, ne parashikojmë që përqindja e provizionit në totalin e portfolios kreditore të jetë rreth 2.7%.

RAPORTET (PROPORCIONET)

	2018	2019	2020	2021
Kreditë / Gjithsejtë Asete	74,73%	66,55%	72,88%	69,65%
Kreditë / Depozitat	116,72%	78,90%	94,49%	95,88%
NPL	0,16%	0,19%	0,35%	0,62%
Gjithsejtë Fitim / Asetet Mesatare (ROA)	-1,15%	0,06%	1,28%	0,67%
Fitimi Neto / Kapitali Mesatar (ROE)	-6,17%	0,54%	11,46%	6,26%
Të Hyrat pa Interes / Shpenzimet pa Interes	9,97%	52,58%	51,81%	35,10%
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	29,1%	22,3%	19,2%	15,1%

**11. PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2021 DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA NË KOSOVË

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE
PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME
STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2021

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	5
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	6
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-58



RSM KOSOVO SH.P.K.

Rr. Xhevdet Doda
Dukagjini Residence, Hyjës
B-C Lam B, Kati 2, nd. 56
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

DI: +383 45 666 888

www.rsm.global/kosovo

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. – Dega në Kosovë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. – Dega në Kosovë ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2021, dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhjes së parash për vitin që përfundon dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabel me të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parash për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare* në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontablistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditor tjetër që ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 30 April 2021.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
AUDIT | TAX | CONSULTING

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rrezeqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.


Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

4 Prill 2022



Astrit Kelmendi

Partner i Angazhimit

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA E KOSOVËS
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
 (Në Euro)

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020
Të ardhurat nga interesi	21	4,230,898	3,371,066
Shpenzimet e interest	21	(1,289,215)	(1,080,456)
Të ardhurat neto nga interesi		2,941,683	2,290,610
Rënia në vlerë (humbja)/kthimi i kredive dhe paradhënies për klientë	10	(854,175)	(38,848)
Të ardhurat neto nga interesi pas lejimit për humbjen nga rënia në vlerë e kredive dhe paradhënies për klientë		2,087,508	2,251,762
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	22	522,161	608,827
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	22	(166,528)	(145,140)
Fitimet minus humbjet nga tregtimi dhe këmbimi valuator		12,540	12,604
Të hyrat tjera operative	23	3,397	68,368
Shpenzimet administrative dhe shpenzimet e tjera operative	24	(1,786,931)	(1,681,987)
Fitimi para tatimit		672,147	1,114,434
Tatimi në Fitim	25	(107,373)	(124,113)
Fitimi i vitit		564,774	990,321
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse: <i>Zërat që mund të ri-klasifikohen në fitim ose humbje në periudhat e më vonshme:</i> Investimi në letrat me vlerë të matura me VDPHTGJ		-	2,613
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin		564,774	992,934

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe që janë pjesë e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 7 deri në 58.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA E KOSOVËS
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Më 31 dhjetor 2021
 (Në Euro)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Pasuritë			
Paraja në arkë dhe në banka	8	12,051,084	1,873,383
Balancat me Bankën Qendrore të Kosovës	9	7,065,869	8,097,791
Kreditë për klientë	10	65,514,143	56,491,092
Investimet në letra me vlerë të matura në VDPHTGJ	11	7,003,986	6,857,819
Prona dhe paisje	12	966,992	627,682
Pasuri të paprekshme	13	205,572	278,288
Parapagimi i tatimit në fitim		27,707	-
Pasuritë e shtyera tatimore	25	-	38,495
Pasuritë e tjera	15	252,113	283,608
Te drejtat për përdorim të pasurive	14	763,616	898,136
Gjithseje pasuritë		93,851,082	75,446,294
Detyrimet			
Detyrimet ndaj klientëve	16	69,870,193	58,483,452
Detyrimet ndaj bankave dhe huamarrësve	17	4,034,370	2,459,655
Detyrimet ndaj bankave të palëve të lidhura	18	9,544,738	4,552,724
Detyrime tjera	19	118,283	112,405
Detyrimet nga qiraja	14	786,856	906,191
Gjithsej detyrimet		84,354,440	66,514,427
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali aksionar	20	10,000,000	10,000,000
Humbja e akumuluar		(511,617)	(1,076,391)
Rezerva e rivlerësimit për investimet në letra me vlerë të matura në VDPHTGJ		8,259	8,259
Gjithsej kapitali dhe rezervat		9,496,642	8,931,868
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezerva		93,851,082	75,446,294

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 7 deri 58.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Menaxhues dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 1 Prill 2022 nga:

Meriton Sunduri
 Drejtor për Kosovë

Agnesa Vezgishi
 Menaxhere per Kordinim
 Financiar

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(Në Euro)

	Kapitali aksionar	Humbja e akumuluar	Rezerva e rivlerësimit	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2020	10,000,000	(2,066,712)	5,645	7,938,933
Fitimi për vitin	-	990,321	-	990,321
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	2,613	2,613
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	990,321	2,613	992,934
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	10,000,000	(1,076,391)	8,259	8,931,867
Gjendja më 1 janar 2021	10,000,000	(1,076,391)	8,259	8,931,868
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse				
Fitimi për vitin	-	564,774	-	564,774
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjithsej të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	564,774	-	564,774
Gjendja më 31 Dhjetor 2021	10,000,000	(511,617)	8,259	9,496,642

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 7 deri 58.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Në Euro)

	Shënime	Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021	Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		672,147	1,114,434
Rregullimet për:			
Amortizim dhe zhvlerësim	12,13&14	482,195	482,487
Humbja neto nga rënia në vlerë e kredive për klientë	10	854,175	38,848
Humbje e pritshme kreditore e pasurive të tjera financiare	24	9,725	-
Të ardhurat nga interesi	21	(4,230,898)	(3,371,066)
Shpenzimet e interesit	21	1,289,215	1,080,456
Humbja para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		(923,441)	(654,841)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rezerva obligative	8	139,790	269,595
Rezerva obligative – 10%	8	144,540	(5,187,001)
Kreditë për klientë	10	(9,930,726)	(12,331,787)
Pasuri të tjera	15	31,495	(244,330)
Detyrimet ndaj klientëve	16	11,211,131	14,578,870
Detyrimet ndaj bankës	17&18	6,496,254	(4,801,973)
Detyrime tjera	19	(3,694)	675,950
		7,165,349	(7,695,516)
Tatimi mbi të ardhurat e paguar		(96,585)	-
Interesi i pranuar		4,282,465	3,206,183
Interesi i paguar		(1,000,531)	(942,542)
Paraja neto (përdorur) / e gjeneruar nga aktivitetet operative		10,350,698	(5,431,875)
Aktivitetet investive			
Blerja e pronave, pajisjeve dhe e pasurive të paprekshme	12,13&14	(614,268)	(949,189)
Kthimet neto / (blerja) e letrave me vlerë	11	(144,387)	(268,694)
Paratë neto (të përdorura) në aktivitetet investuese		(758,655)	(1,217,883)
Aktivitetet financuese			
Paratë neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese	14	(161,934)	-
		(161,934)	-
Neto Rritja (zvoglimi) e parasë dhe ekuivalentëve të parasë		9,430,109	(6,649,758)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		4,644,383	11,294,141
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	8	14,074,492	4,644,383

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet dhe pjesët përbërëse të pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 7 deri 58.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. Informata të përgjithshme

Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S. - Dega e Kosovës ("Banka") është një shoqëri aksionare e themeluar në Republikën e Kosovës. Adresa e zyrës qendrore të regjistruar është Ukshin Hoti Nr.13,10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka mori licencën për veprimtari bankare më 2 qershor 2015 dhe filloi veprimtarinë më 7 qershor 2015. Banka vepron si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 4 degëve kryesore në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj. Banka ka të punësuar 31 punonjës më 31 dhjetor 2021 (29 punonjës më 31 dhjetor 2020).

2. Bazat e përgatitjes

Deklarata e përputhshmërisë. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas konventës historike, e modifikuar sipas rivlerësimit të investimeve në letrat me vlerë të matura me VDPHTGJ. Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe.

Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve. Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive. Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 4, 5 and 6.

Monedha funksionale dhe prezantimi. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në EUR, e cila është monedha funksionale e Bankës, monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin njësia vepron. Të gjitha shumat janë rrumbullaksuar në mijëshen më të afërt, përveç kur tregohet ndryshe.

Parimi i vazhdueshmërisë. Menaxhmenti vazhdon të ketë një pritje të arsyeshme që banka të ketë burime adekuate për të vazhduar operimin për të paktën 12 muajt e ardhshëm dhe që baza e vazhdueshmërisë në kontabilitetin të mbetet e përshtatshme. Përhapja e pandemisë COVID-19 dhe masat e miratuara nga qeveria në Kosovë për të zbutur përhapjen e saj nuk kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në Bankë. Megjithatë Banka ka akumuluar humbje prej 511,617 EUR në 31 dhjetor 2021, ajo e ka mbyllur vitin me një fitim prej 564,774 EUR dhe ka një kapital total pozitiv prej 9,496,642 EUR.

Sidoqoftë, ka ende paqartësi se si zhvillimet e ardhshme do të ndikojnë në biznesin e Bankës dhe kërkesën e klientit për produktet e saj. Në datën e autorizimit të pasqyrave financiare, Banka ka likuiditet të mjaftueshëm dhe baza e vazhdueshmërisë është e përshtatshme.

Banka ka pritje të arsyeshme se mund të vazhdojë të financojë vetë dhe të mbajë raportet e kërkuara të kapitalit.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat e kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Interesi

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv 'Norma efektive e interesit' është norma që saktësisht zbret pagesat dhe arkëtimet e vlerësuar të ardhshme të parasë përmes jetëgjatësisë së pritur të instrumenteve financiare në:

- vlerën kontabël bruto të pasurive financiare, ose
- koston e amortizuar të detyrimeve financiare.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Interesi (vazhdim)

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit për instrumentet financiare tjera nga ato të blera ose nga pasuritë financiare të orientuara nga humbjet e kredisë, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo ECL. Për blerjet ose pasuritë financiare të orientuara nga humbjet e kredisë, llogaritet një normë efektive e interesit rregullues të kredisë duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara përfshirë ECL.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot dhe tarifat e transaksionit si dhe pikat e paguara ose të pranuar që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar.

Kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

'Kostoja e amortizuar' e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma në të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e principalit, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj vlere fillestare dhe shumës së maturimit dhe për pasuritë financiare, të rregulluara për çdo zbritje të humbjes së kredisë (ose zbritje nga zhvlerësimi përpara datës 1 janar 2018).

'Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare' është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të korrigjohet për çdo zbritje të pritshme të humbjes së kredisë.

Llogaritja e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi

Norma efektive e interesit të një pasurie financiare ose detyrimi financiar llogaritet në njohjen fillestare të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të pasurisë (kur pasuria nuk është e dëmtuar nga kredia) ose në koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si rezultat i rivlerësimit periodik të flukseve të mjeteve monetare të instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut.

Sidoqoftë, për pasuritë financiare që kanë pësuar rënie në vlerë të kredisë pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare. Nëse pasuria nuk është më me rënie në vlerë të kredisë, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi rikthehet në bazë bruto.

Për pasuritë financiare të cilat kanë pësuar rënie në vlerë të kredisë në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit rregullues të kredisë në koston e amortizuar të pasurisë. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza nominale, edhe nëse rreziku i kredisë së pasurisë përmirësohet.

(b) Tarifat dhe komisionet

Tarifat të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë tarifat e fillimit të arkëtuara ose të paguara nga subjekti, lidhur me krijimin ose blerjen e pasurive financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, për shembull, tarifat për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumenteve dhe tarifat për përpunimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifat e zotimit, të arkëtuara nga banka për të nisur kredi me normat e interesit të tregut, janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse ka gjasa që banka të hyjë në një marrëveshje specifike për kredidhënie dhe nuk pret ta shesë kreditin rezultuese menjëherë pas nisjes së saj. Të gjitha tarifat e tjera, të cilat janë pjesë përbërëse e llogaritjes së normës efektive të interesit, paraqiten në zërin e të ardhurave nga interesi.

Të gjitha tarifat e tjera, komisionet dhe zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera zakonisht regjistrohen në bazë akruale duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit real të ofruar si një pjesë e shërbimeve të përgjithshme do të ofrohen. Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet përbëhen nga tarifat dhe komisionet nga (për): kredit kartelat, tarifat e shërbimit të llogarisë, pagesat ndërkombëtare, pagesat vendore, pagesat e Bankës Qendrore, SMS banking, garancitë dhe letrat e kreditit si dhe tarifat dhe komisionet tjera. Taksa dhe komisione të tjera njihen si shërbime të lidhura. Shpenzimet e tjera të komisioneve dhe komisioneve kanë të bëjnë kryesisht me tarifat e transaksionit dhe shërbimit, të cilat janë shpenzuar kur shërbimet janë pranuar.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja janë kthyer në valutën funksionale, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale të bankës me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutë të huaj të konvertuar në valutë funksionale me kursin e fundvitit.

Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga konvertimi përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

(d) Tatimi në fitim

Tatimet në fitim janë paraqitur në pasqyra financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar, si dhe me legjislacionin e hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

Ngarkesa e tatimit në fitim përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi në fitim i shtyrë dhe njihet në pasqyrën e fitimit dhe të humbjes së vitit, përveç nëse njihet në të ardhurat tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, pasi që ndërlidhet me transaksionet të cilat gjithashtu njihen në periudhën e njëjtë ose në periudhë tjetër, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe paraprake. Fitimet dhe humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare autorizohen para dorëzimit të kërkesave relevante për rimbursim të tatimit. Tatimet tjera të ndryshme nga tatimi në fitim regjistrohen në kuadër të shpenzimeve administrative dhe operative.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit të gjendjes për bartjet e humbjeve nga tatimi dhe diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të pasurive dhe detyrimeve dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar.

Bilanci i tatimit të shtyrë matet me normat tatimore në fuqi ose të hyra në fuqi në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të aplikohen për periudhën kur diferencat e përkohshme të kthehen ose kur bartjet e humbjeve nga tatimi të përdoren.

Pasuritë tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe bartjet e humbjeve nga tatimi regjistrohen deri në masën që është e mundur për të pasur të ardhura të tatueshme kundrejt të cilave ky aktiv tatimor pritet të përdoren.

(iii) Pozicionet tatimore të pasigurta

Pozicionet tatimore të pasigurta të bankës rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të secilës periudhë raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet tatimore të pasigurta, të cilat përcaktohen nga menaxhmenti si të tilla që ka më shumë gjasa se nuk do të rezultojnë me taksa shtesë të vëna nëse ato pozicione do të kontestoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore të cilat janë në fuqi, ose që kanë hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese dhe çdo aktvendimi gjyqësor të njohur ose të ndonjë organi tjetër lidhur me çështje të tilla. Detyrimet për dënime, interes dhe tatime të ndryshme nga ato në fitim njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të shpenzimeve të bëra nga menaxhmenti që kërkohen për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës raportuese.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Instrumentet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Depozitat dhe detyrimet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot shtesë të drejtëpërdrejta të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

m) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke zbritur flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe rreziqet specifike të detyrimit. Zbërthimi i zbritjes njihet si kosto financiare.

n) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet në planin e pensioneve të administruara publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme të pagesës pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime për përfitimet e punonjësve kur ato duhet të paguhen. Banka ka llogaritur dhe ofruar provizion për pushimin e pashfrytëzuar të stafit nga fundi i periudhës raportuese.

o) Garancionet financiare dhe zotimet e kredisë

Garancionet financiare janë kontrata që kërkojnë nga Banka që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që shkaktohet sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesën kur ajo është e detyrueshme në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Zotimet e kredisë janë angazhime të sigurta për të ofruar kredi sipas afateve dhe kushteve të paracaktuara.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Kapitali aksionar

(i) Shpenzimet e emetimit të aksioneve

Kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat.

(ii) Primi i aksioneve

Primi i aksioneve përfaqëson tejkalimin e kontributit të marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapitalin neto në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionerët e Bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalosen si ngjarje pas përfundimit të periudhës raportuese.

n. Krahaseshmëria

Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në paraqitjen për vitin aktual për qëllime të fluksit monetar.

4. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

a) Adoptimi i standardeve të reja dhe të rishikurara

i) Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Banka ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Adoptimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim signifikant në pasqyrat financiare të bankave.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 janar 2021

- Koncesionet e qirasë të lidhura me COVID-19 pas datës 30 qershor 2021 (Ndryshimet në SNRF 16).
- Faza 2 e Reformës së Standardit të Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16)

ii) Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive (vazhdim)

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por jo ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" përfshirë ndryshimet në SNRF 17 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2023),
- Ndryshime në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4),
- Referencat në Kornizën Konceptuale,
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshime në SNK 16),
- Kontratat e rënda – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshime në SNK 37),
- Përmirësimet vjetore të ciklit të standardeve të SNRF-ve 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Ndryshimet në SNK 1),
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet nga një Transaksion i Vetëm,

Banka ka zgjedhur që të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre efektive. Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

5. Gjykimet kritike të kontabilitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

a) Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material në vitet pasuese është dhënë më poshtë në lidhje me zhvlerësimin e instrumenteve financiare:

(i) Rënia në vlerë për humbjet nga kreditë

Banka shqyrton portofolet e saj të huave për të vlerësuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ulje të konsiderueshme në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar nga një portofol i kredive para se të mund të identifikohet rënia me një hua individuale në atë portofol. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesave të huamarrësve në një grup, ose kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në Bankë.

Menaxhmenti përdor vlerësime bazuar në përvojën historike të humbjes për aktivet me karakteristika të riskut të kredisë dhe dëshmi objektive të zhvlerësimit të ngjashëm me ato të portofolit gjatë caktimit të flukseve monetare të ardhshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

Bazuar në vlerësimin e menaxhmentit, pandemia COVID 19 nuk ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në vlerën kontabël të huave dhe paradhënieve të bankës më 31 Dhjetor 2021 dhe provizioni i humbjes së huasë i regjistruar më 31 Dhjetor 2021 është i përshtatshëm.

6. Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie risqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e një shkalle risku ose kombinimi të risqeve. Marrja e riskut është thelbësore për biznesin financiar dhe risqet operationale janë një pasojë e pashmangshme për të qenë në biznes. Qëllimi i Bankës është, pra, të arrijë një ekuilibër të përshtatshëm midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet e mundshme negative në ecurinë financiare të Bankës.

Politikat e menaxhimit të riskut të Bankës janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të vendosur kufizimet dhe kontrollet e duhura të riskut si dhe për të monitoruar risqet dhe respektuar kufizimet nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit. Banka rregullisht shqyrton politikat dhe sistemet e saj të menaxhimit të riskut për të pasqyruar ndryshimet në tregjet, produktet dhe praktikatat më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i riskut kryhet kryesisht nga Funksioni i Monitorimit të Riskut dhe Departamenti i Riskut të Kredisë që punojnë sipas politikave të administrimit të riskut të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politikat me shkrim që mbulojnë fusha specifike, të tilla si, risku i kredisë, risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit dhe risku i likuiditetit. Përveç kësaj, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të menaxhimit të riskut dhe mjedisit të kontrollit.

a) Risku i kredisë

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që pala tjetër të shkaktojë një humbje financiare për Bankën duke mos përmbushur një detyrim. Risku i kredisë është i përhapur në biznesin e Bankës; prandaj menaxhmenti menaxhon me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredive lindin kryesisht në aktivitetet huadhënëse që çojnë në kreditë dhe paradhëniet si dhe aktivitetet e investimit që sjellin vendosje dhe letra me vlerë të borxhit në portfolion e pasurive të Bankës.

Ekziston edhe risku i kredisë në instrumentet financiare jashtë bilancore, siç janë letrat e kreditit, garancionet dhe zotimet e kredisë. Menaxhimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për kreditë dhe paradhëniet janë të centralizuara në departamentin e menaxhimit të riskut të kredisë, ndërkohë që risku ndërbankar për vendosjet dhe letrat me vlerë të borxhit janë të përqendruara në departamentet e Thesarit dhe të Menaxhimit të Riskut. Të gjitha departamentet përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë, raportojnë rregullisht në Bordin Menaxhues dhe në Bordin e Drejtorëve.

(i) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacion në lidhje me cilësinë e kredisë së pasurive financiare dhe lejimin për rënien në vlerë/ humbjen e mbajtur nga Banka kundrejt këtyre pasurive.

Tabela përfaqëson një skenar të rastit më të keq të ekspozimit ndaj riskut të kredisë të Bankës më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur ose përmirësime të tjera të bashkangjitura të kredisë. Për pasuritë financiare, ekspozimet e paraqitura më poshtë paraqesin vlerën kontabël neto të raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

	Kreditë për klientë		Investimet në letrat me vlerë		Gjendjet me bankat dhe me BQK-në	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë						
Vlera bartëse	65,514,143	56,491,092	7,003,986	6,864,982	18,444,070	9,133,708
Shuma e zotuar / e garantuar	3,616,795	2,618,322	-	-	-	-
	69,130,938	59,109,414	7,003,986	6,864,982	18,444,070	9,133,708
Me koston e amortizuar						
Faza 1	63,054,498	53,028,106	7,011,300	6,864,982	18,471,745	9,133,708
Faza 2	3,408,287	3,773,996	-	-	-	-
Faza 3	416,482	199,939	-	-	-	-
Gjithsej	66,879,267	57,002,041	7,011,300	6,864,982	18,471,745	9,133,708
Lejimi për rënien në vlerë (individuale dhe kolektive)	1,365,124	510,949	7,315	7,162	27,675	13,681
Vlera kontabël neto	65,514,143	56,491,092	7,003,986	6,857,820	18,444,070	9,120,027
Jastë bilancit: ekspozimi maksimal						
Garancionet financiare: Rreziku i ulët-fer	3,616,795	2,618,322	-	-	-	-
Gjithsej zotuar / garantuar	3,616,795	2,618,322	-	-	-	-
Provizionet e njohura si detyrime	18,048	8,476	-	-	-	-
Gjithsej ekspozimet	3,598,747	2,609,846	-	-	-	-

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Paraja dhe balancat me bankat qendrore

Paraja dhe llogaria rrjedhëse me bankat nuk janë as në vonesë, as nuk kanë pësuar rënie në vlerë dhe nuk janë të kolateralizuara. Cilësia e kredisë së parasë së gatshme dhe balancat me bankat qendrore është dhënë më poshtë. Bankës Qendrore të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës nuk i ofrohet një vlerësim nga agjencitë e njohura të vlerësimit.

Më 31 Dhjetor

	2021	2020
AA+ to AA-	-	-
A+ to A-	-	-
BB+ to B-	11,135,702	729,050
BBB+ to B-	-	-
E pa vlerësuar	-	-
Bankat vendore	7,336,043	8,404,658
	18,471,745	9,133,708

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku kreditor (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet për klientë

	2021		2020	
	Individët	Korporata	Gjithsej kreditë	Gjithsej kreditë
Kreditë dhe paradhëniet për klientë				
Gjithsej shuma bruto	2,292,905 (79,915)	64,586,362 (1,285,209)	66,879,267 (1,365,124)	57,002,041 (510,949)
Lejimi për rënie në vlerë (individuale dhe kolektive)				
Vlera kontabël neto	2,212,990	63,301,153	65,514,143	56,491,092
<i>Me koston e amortizuar</i>				
Faza 1	2,214,004	60,840,494	63,054,498	53,028,106
Faza 2	13,823	3,394,464	3,408,287	3,773,996
Faza 3	65,078	351,404	416,482	199,939
Gjithsej Bruto	2,292,905	64,586,362	66,879,267	57,002,041
Minus: lejimi për kredi të provizionuara individualisht				
Minus: lejimi për kredi të provizionuara kolektivisht	(79,915)	(1,285,209)	(1,365,124)	(510,949)
Gjithsej lejimi për rënie në vlerë	(79,915)	(1,285,209)	(1,365,124)	(510,949)
Kreditë me terma të rinegociuara				
Vlera kontabël	-	-	-	-
Lejimi për rënie në vlerë	-	-	-	-
Vlera kontabël neto	2,212,990	63,301,153	65,514,143	56,491,092

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Rënia në vlerë dhe provizionimi

Provizionet e rënies në vlerë njihen për qëllime të raportimit financiar vetëm për humbjet që kanë ndodhur në datën e raportimit bazuar në evidencën objektive të zhvlerësimit [shih politikën e kontabilitetit 2 (g) (vii)].

Politika e Bankës kërkon shqyrtimin e aseteve individuale financiare që janë mbi pragun e materialitetit të paktën një herë në vit ose më shumë kur rrethanat individuale kërkojnë atë. Lejimet për rëniet në vlerë për ekspozimet individuale të vlerësuara përcaktohen nga një vlerësim i humbjes së ndodhur në datën e raportimit në baza rast pas rasti dhe zbatohen për të gjitha ekspozimet me rëndësi individuale. Vlerësimi normalisht përfshin kolateralin e mbajtur (duke përfshirë ri-konfirmimin e zbatueshmërisë së tij) dhe faturat e parapara për atë llogari individuale. Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit të një grupi të aktiveve financiare bazohet në një analizë sasiore të normave të vonësive historike për portofoliot e huave me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë. Normat sasiore të parazgjedhura të llogaritura në këtë mënyrë u nënshtrohen një analize cilësore (analiza e migrimit).

Banka përdor modelin e pritur të humbjes në vlerë që kërkon njohjen e humbjeve të pritshme të kredisë në kohën e duhur për të siguruar që shuma e humbjeve të pritshme të kredisë të njohura në çdo datë raportimi pasqyron ndryshimet në riskun e kredisë të instrumenteve financiare. Modeli është i ardhshëm dhe zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura për njohjen e humbjeve të kreditit, duke njohur humbjet e kreditit që jo domosdoshmërisht janë shkaktuar nga një ngjarje e mundshme humbjeje.

Në mënyrë të veçantë, modeli adreson kërkesat e SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritura të kredisë bazuar në informacione të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacione historike, aktuale dhe të parashikuara.

Ky model përshkruan tri faza bazuar në ndryshimet në rrezikun e ekspozimit ndaj kredisë që nga data e njohjes fillestare.

Faza 1 përfshin ekspozimet që nuk kanë pasur një rritje të konsiderueshme në riskun e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë risk të ulët të kredisë në datën e raportimit, duke përfshirë ato që kthehen nga Faza II për shkak të uljes së riskut të kredisë. Për këto ekspozime, humbjet kreditore të pritura njëvjeçare njihen në fitimin ose humbjen dhe përcaktohet një lejim humbjeje. Humbjet e pritshme njëvjeçare i referohen humbjeve të pritshme të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e falimentimit të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Faza 2 përfshin ekspozimet që kanë pasur një rritje të konsiderueshme në riskun e kredisë që nga njohja fillestare (përveç nëse ata kanë risk të ulët të kredisë në datën e raportimit). Për këto asete, humbjet e pritura gjatë jetës njihen. Humbjet e pritura gjatë jetës janë humbjet e pritura të kreditit që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të papaguara gjatë jetës së pritshme - maturimi i një kredie.

Faza 3 përfshin ekspozimet që kanë dëshmi objektive të rënies në vlerë në datën e raportimit. Për këto asete, njihen humbjet e pritshme gjatë jetës dhe të ardhurat nga interesi llogariten mbi koston e amortizuar.

Politika e shlyerjeve

Banka shlyen një balancë të kredisë/ letrave me vlerë (dhe ndonjë lejim të lidhur për humbjet nga rënia në vlerë) kur përcaktohet se kreditë / letrat me vlerë nuk janë të arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pas marrjes në konsideratë të informatave të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit / emetuesit, në mënyrë që huamarrësi / emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të ripaguar tërë ekspozimin. Sa më e vogël të jetë shuma e papaguar, aq më i lartë është numri i ditëve në vonësë dhe sa më të mëdha të jenë pasiguritë rreth rikuperimit (siç është një mjedis i paparashikueshëm ligjor), aq më të vogla do të jenë shanset e rimëkëmbjes nga Banka.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(i) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Zotimet e kredisë dhe garancionet financiare

Ekspozimi maksimal nga garancionet financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka do të paguajë nëse kërkohet garancioni, i cili mund të jetë dukshëm më i madh se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për zotimet e huadhënies është shuma e plotë e zotimit (shih Shënimin 26).

(ii) *Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut*

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon e përqendrimet e riskut të kredisë kudo që ato identifikohen në mënyrë të veçantë tek palët tjera dhe grupet individuale, si dhe tek bashkëpunëtorët.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës të vetëm ose grup huamarrësish si dhe në segmentet gjeografike dhe të industrisë. Këto risqe monitorohen në baza të rregullta dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme. Kufizimet në nivelin e riskut të kredisë sipas sektorit të produktit, rajonit dhe industrisë miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë udhëhiqet gjithashtu nëpërmjet analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësve dhe huamarrësve potencial për të përmbushur detyrimet e ripagimit të interesit dhe të kapitalit si dhe duke ndryshuar kufizimet e huadhënies aty ku është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat zbutëse janë të përshkruara më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësimet e tjera të kredisë, si dhe efektet e tyre financiare

Banka përdor një sërë politikash dhe praktikash për të zbutur riskun e kredisë, më e zakonshme nga të cilat është siguria për përparimin e fondeve. Banka zbaton udhëzime për pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit ose zbutjen e riskut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për huatë dhe paradhëniet janë:

- Hipotekat mbi pronat banesore;
- Ngarkesat mbi asetet e biznesit si ndërtesa, pajisje dhe inventar; dhe
- Ngarkesat mbi paranë e gatshme dhe ekuivalentët e saj (kolaterali i parasë së gatshme).

Në përgjithësi, kreditë ndaj subjekteve të korporatave dhe individëve sigurohen; mbitërheqjet individuale dhe kredit kartelat e lëshuara për individët sigurohen nga kolaterali i parasë ose lloje të tjera kolaterali të përcaktuara me vendim të komisioneve të kredive.

Përveç kësaj, me qëllim që të minimizohet humbja e kredisë, Banka do të kërkojë kolateral shtesë nga pala tjetër sapo treguesit e zhvlerësimit të shënohen për huatë dhe paradhëniet përkatëse individuale.

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shpalosur vlerat kolaterale veçmas për:

- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë të barabarta ose tajaklojnë vlerën kontabël të pasurisë (“pasuri të mbingarkuara”); dhe
- Ato pasuri ku kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë janë më të vogla se vlera kontabël e pasurisë (“pasuri nën kolateral”);

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(ii) Politika e kontrollit të limitit dhe zvogëlimit të riskut (vazhdim)

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësimet e tjera të kredisë, si dhe efektet e tyre financiare (vazhdim)

	2021		2020	
	Kredi dhe avanse per kliente	VD e kolateralit	Kredi dhe avanse per kliente	VD e kolateralit
Hipotekat	23,141,576	144,067,153	39,765,739	137,692,595
Kolaterali në para	705,052	1,572,101	2,458,254	921,508
Pengu	23,097,846	96,628,709	8,963,130	34,249,845
Mikse (hipoteka dhe pengu)	11,517,717	118,452,345	5,303,969	147,044,549
Jo të kolateralizuara	7,051,952	-	-	-
Gjithsej	65,514,143	360,720,308	56,491,092	319,908,497

Vlera e drejtë e kolateralit vlerësohet nga Banka në baza individuale. Vlerat e vlerësuara përgjithësisht përcaktohen duke i'u referuar tregut. Të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit gjithashtu merren parasysh në llogaritjen e provizioneve individuale të rënies në vlerë.

(iii) Përqëndrimi i riskut kreditor

Përqëndrimet lindin kur një numër i palëve janë të angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit ose aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, apo kanë karakteristika të ngjashme ekonomike të cilat do të shkaktonin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike, politike ose të tjera. Përqëndrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të performancës së Bankës ndaj zhvillimeve që ndikojnë në një industri të caktuar ose vendndodhjen gjeografike.

Sektorët gjeografik

Tabela në vijim shpalos ekspozimin kryesor kreditor të Bankës në shumën e tyre bruto, sipas kategorive të rajonit gjeografik më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020. Banka ka ndarë ekspozimet ndaj rajoneve bazuar në vendin e banimit të palëve të saj.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

(iii) Përqëndrimi i riskut kreditor (vazhdim)

Banka monitoron përqëndrimet e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe sipas vendndodhjes gjeografike. Një analizë e përqëndrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kreditë për klientë		Investimet në letrat me vlerë		Gjendjet me bankat dhe BQK-në	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Përqëndrimi sipas sektorit						
Qeveria	-	-	7,003,986	6,857,819	-	-
Bankat	-	-	-	-	18,444,070	9,120,027
Bujqësia	485,350	547,205	-	-	-	-
Ndërtimi	7,478,519	5,471,038	-	-	-	-
Edukimi dhe puna sociale	761,312	646,784	-	-	-	-
Elektriciteti dhe të ngjashme	10,256,881	12,098,861	-	-	-	-
Individët	2,212,990	1,417,833	-	-	-	-
Prodhimtaria	14,086,560	8,951,818	-	-	-	-
Sherbimet	7,302,257	6,969,572	-	-	-	-
Tregtia	22,930,274	20,387,981	-	-	-	-
Gjithsej	65,514,143	56,491,092	7,003,986	6,857,819	18,444,070	9,120,027
Përqëndrimi sipas vendndodhjes						
Republika e Turqisë	-	-	-	-	11,070,042	470,570
Vendet e BE	-	-	-	-	48,958	257,367
Republika e Kosovës	65,514,143	56,491,092	7,003,986	6,857,819	7,325,070	8,392,090
Gjithsej	65,514,143	56,491,092	7,003,986	6,857,819	18,444,070	9,120,027

Gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2021 nuk është nxjerrë “Udhëzuesi i BQK-së për ristrukturimin e kredisë për shkak të COVID 19”, udhëzimet e nxjerra gjatë vitit 2020 kanë përfunduar më 30 Shtator 2020.

31 Dhjetor 2020

Në përputhje me “Udhëzuesin e BQK-së për ristrukturimin e kredisë për shkak të COVID 19” të lëshuar më 16 Mars 2020, Banka ka shtyrë pagesat e kësteve të kredisë deri në 3 muaj për të gjithë klientët që kanë bërë një kërkesë (COVID 19-faza e parë). Më 31 Dhjetor 2020, tepricat e kredive të shtyra në fazën e parë (për 3 muaj) arrijnë në 6,443,657 euro.

Gjithashtu, BQK-ja ka nxjerrë një Udhëzues për ristrukturimin e kredive për shkak të COVID 19 më 8 Qershor 2020, në bazë të të cilit Organizata ka ristrukturuar kreditë për të gjithë klientët që kanë bërë kërkesë për të lejuar zgjatjen e maturimit deri në 12 muaj (COVID 19 – faza e dytë). Më 31 Dhjetor 2020, tepricat e kredive të ristrukturuara në fazën e dytë (deri në 12 muaj) arrijnë në 8,961,106 euro.

(b) Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si normat e valutave të huaja, normat e interesit, çmimet e kapitalit dhe diferencat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në pozicionin e kreditorit / emetuesit) do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin në rrezik.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021
(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj

Risku i valutës është risku që vlera e një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor. Banka synon të mos përfitojë nga ndonjë transaksion spekulativ, ajo përpaket të mbajë pozicionin e saj të hapur ndaj valutave të huaja në afërsi të zeros gjatë gjithë kohës. Kufijtë e pozicionit të hapur të valutës dhe kapaciteti për marrjen e riskut për Bankën përcaktohen nga politikat përkatëse, të cilat miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe shqyrtohen nga Funkzioni i Monitorimit të Riskut. Kufijtë e rregullatorit në çdo kohë respektohen nga Banka.

Njësia e Thesarit vlerëson zhvillimet e kursit të këmbimit në lidhje me të gjitha pozicionet valutore materiale. Ndryshimet e mëdha në strukturën e pasurive dhe detyrimeve të shprehura në valutë të huaj dhe impakti i tyre rishikohen para se të realizohen tregtime nga departamenti i zyrës së thesarit të bankës.

Njësia e Thesarit gjithashtu vëzhgon tregun financiar dhe informon Funkzionin e Monitorimit të Riskut rregullisht dhe në rast të zhvillimeve të rëndësishme që mund të ndikojnë në gjendjen e riskut të valutës së Bankës.

Edhe pse Banka synon të mbajë pozicionin e saj të valutës sa të jetë e mundur më afër zeros, mund të ketë raste kur Banka ende ndikohet nga paqëndrueshmëria e paparashikuar e kursit të këmbimit. Prandaj, Funkzioni i Monitorimit të Riskut kryen teste të stresit dhe raporton efektet në Fitimin ose Humbjen e Bankës në baza mujore.

Normat zyrtare të këmbimit për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit të shprehur në monedha të huaja ishin si më poshtë (në EUR):

Valuta	2021 EUR	2020 EUR
1 USD	0.88	0.81
1 CHF	0.97	0.93
1 GBP	1.19	1.11
1 TRY	0.07	0.11

Tabelat në vijim përmbledhin pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në valutë të huaj më 31 Dhjetor 2021 dhe 2020, të konvertuara në euro.

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.S. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(i) Risku i valutës së huaj (vazhdim)

31 Dhjetor 2021	EUR	USD	CHF	GBP	TRY	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja në arkë dhe në bank	11,821,432	169,858	55,428	4,364	2	12,051,084
Balanca me BQK	7,065,869	-	-	-	-	7,065,869
Kredi per klient	65,514,143	-	-	-	-	65,514,143
Investimet në letrat me vlerë	7,003,986	-	-	-	-	7,003,986
Pasuritë tjera	252,113	-	-	-	-	252,113
	91,657,543	169,858	55,428	4,364	2	91,887,195
Detyrimet						
Detyrimet ndaj klientëve	69,652,163	214,557	3,473	-	-	69,870,193
Detyrimet ndaj bankës	4,034,370	-	-	-	-	4,034,370
Borxhi i varur	9,544,738	-	-	-	-	9,544,738
Detyrimet tjera	118,283	-	-	-	-	118,283
Detyrimet ndaj qiramarrjes	786,856	-	-	-	-	786,856
	84,136,410	214,557	3,473	-	-	84,354,440
Pozicioni neto në valutë të huaja	7,521,133	(44,699)	51,955	4,364	2	7,532,755

31 Dhjetor 2020	EUR	USD	CHF	GBP	TRY	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja në arkë dhe në bank	1,774,587	41,624	52,930	4,079	163	1,873,383
Balanca me BQK	8,097,791	-	-	-	-	8,097,791
Kredi per kliente	56,491,092	-	-	-	-	56,491,092
Investimet në letrat me vlerë	6,857,819	-	-	-	-	6,857,819
Pasuritë tjera	283,608	-	-	-	-	283,608
	73,504,897	41,624	52,930	4,079	163	73,603,693
Detyrimet						
Detyrimet ndaj klientëve	58,416,632	63,477	3,343	-	-	58,483,452
Detyrimet ndaj bankës	2,459,655	-	-	-	-	2,459,655
Borxhi i varur	4,552,724	-	-	-	-	4,552,724
Detyrimet tjera	112,405	-	-	-	-	112,405
	65,541,416	63,477	3,343	-	-	65,608,236
Pozicioni neto në valutë të huaja	7,963,481	(21,853)	49,587	4,079	163	7,995,457

Tabela më poshtë përmbledh analizën e ndjeshmërisë për rrezikun e monedhës së huaj dhe efektin mbi fitimin ose humbjen dhe kapitalin neto të Bankës neto nga tatimi:

	Rritja 2021	Rritja 2020	Efekti mbi fitimin ose humbjen dhe kapitalin neto	
			31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
USD	10%	10%	(4,470)	2
Tjera	10%	10%	5,632	42

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të ndryshme që lidhen me efektet e luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset e mjeteve monetare. Banka nuk synon të përfitojë fitime nëpërmjet transformimit të maturitetit të tepërt, ose formave të tjera të spekulimeve në tregun e normave të interesit. Përkundrazi, Banka synon të sigurojë që struktura e pasurive dhe detyrimeve të jetë e balancuar në të gjitha maturitetet.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të ekspozimit të riskut të normës së interesit të Bankës ndaj aseteve dhe detyrimeve financiare jotregtare. Asetet dhe detyrimet e Bankës përfshihen në vlerën kontabël dhe kategorizohen sipas rëqimit kontraktual të mëparshëm ose datës së maturimit.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit

Tabelat e mëposhtme përmbledhin ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Të përfshira në tabela janë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës me norma interesi fikse dhe jo fikse.

31 Dhjetor 2021

Pasuritë

	1 - 30 ditë	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Pa interes	Gjithsej
Paraja në dorë dhe në bank	-	-	-	-	-	-	12,051,084	12,051,084
Balanca me BQK	7,065,869	-	-	-	-	-	-	7,065,869
Kreditë për klientë - norma fikse	247,531	64,335	219,028	21,469,886	26,487,445	17,025,918	-	65,514,143
Investimet në letrat me vlerë - norma fikse	-	251,429	1,140,865	249,931	5,361,761	-	-	7,003,986
Pasuri tjera	-	-	-	-	-	-	252,113	252,113
Gjithsej	7,313,400	315,764	1,359,893	21,719,817	31,849,206	17,025,918	12,303,197	91,887,195

Detyrime

Detyrimet ndaj klientëve - norma fikse	1,000,358	-	158,051	24,446,849	24,011,333	125,331	20,128,271	69,870,193
Detyrimet ndaj bankave	-	-	-	3,731,811	302,559	-	-	4,034,370
Borxhi i varur - norma fikse	4,509,738	-	-	5,035,000	-	-	-	9,544,738
Detyrime tjera	-	-	-	-	-	-	118,283	118,283
Detyrimet e qiramarrjes	-	-	-	119,481	407,338	260,037	-	786,856
Gjithsej	5,510,096	-	158,051	33,333,141	24,721,230	385,368	20,246,554	84,354,440
Hendeku	1,803,304	315,764	1,201,842	(11,613,324)	7,127,976	16,640,550	(7,943,357)	7,532,755
Hendeku kumulativ	1,803,304	2,119,068	3,320,910	(8,292,414)	(1,164,438)	15,476,112	7,532,755	-

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2020	1 - 30 ditë	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Pa interes	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja në dorë dhe në bank	-	-	-	-	-	-	1,873,383	1,873,383
Balanca me BQK	7,958,000	-	-	-	-	-	139,791	8,097,791
Kreditë për klientë - norma fikse	-	-	-	-	6,857,819	-	-	6,857,819
Investimet në letrat me vlerë - norma fikse	-	9,888	166,135	15,848,297	20,136,042	20,330,730	-	56,491,092
Pasuri tjera	-	-	-	-	-	-	283,608	283,608
Gjithsej	7,958,000	9,888	166,135	15,848,297	26,993,861	20,330,730	2,296,782	73,603,693
Detyrime								
Detyrimet ndaj klientëve - norma fikse	1,000,419	-	975,130	27,246,962	14,129,695	125,432	15,005,814	58,483,452
Detyrimet ndaj bankave	-	-	20,120	2,051,445	388,090	-	-	2,459,655
Borxhi i varur - norma fikse	4,552,724	-	-	-	-	-	-	4,552,724
Detyrime tjera	-	-	-	-	-	-	112,405	112,405
Gjithsej	5,553,143	-	995,250	29,298,407	14,517,785	125,432	15,118,219	65,608,236
Hendeku	2,404,857	9,888	(829,115)	(13,450,110)	12,476,076	20,205,298	(12,821,437)	7,995,457
Hendeku kumulativ	2,404,857	2,414,745	1,585,630	(11,864,480)	611,596	20,816,894	7,995,457	

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(b) Risku i tregut (vazhdim)

(ii) Risku i normës së interest (vazhdim)

Pasuritë	<i>USD</i>		<i>EUR</i>		<i>CHF</i>	
	2021	2020	2021	2020	2021	2020
Paraja në arkë dhe në bank		-	-	-		-
Balanca me BQK		-	-	-		-
Kreditë për klientë		-	6.10%	6.11%		-
Investimet e letrave me vlerë		-	1.47%	1.64%		-
Detyrimet						
Depozitat e klientëve		-	2.22%	1.59%		-
Borxhi i varur		-	1.68%	1.11%		-

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt kufijve të hendekut të normës së interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aseteve dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj skenarëve të ndryshëm të normave standarde dhe jo standarde të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie paralele 1% ose rritje në të gjitha kthesat e rendimentit.

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka më nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj të tanishme dhe të ardhshme të pagesave në mënyrë të plotë, ose në kohën e duhur. Prandaj, Banka duhet të mbajë në çdo kohë fonde të mjaftueshme likuide në dispozicion për të përmbushur detyrimet e saj, edhe në rast të rrethanave të mundshme të jashtëzakonshme. Risku i likuiditetit është gjithashtu risku që financimi shtesë nuk mund të merret më, ose mund të merret vetëm me rritjen e normave të interesit të tregut. Kjo mund të shkaktohet nga ndërprerjet e tregut ose uljet e kreditit të cilat mund të shkaktojnë që burimet e caktuara të financimit të mos bëhen të disponueshme. Për të zvogëluar riskun e likuiditetit, Banka diversifikon burimet e financimit dhe menaxhon pasuritë duke marrë masa të likuiditetit, duke ruajtur një gjendje të parasë së gatshme dhe të ekuivalentëve të parasë, mjaftueshëm për të përmbushur thirrjet e detyrimeve të menjëhershme.

Tabela më poshtë paraqet analizën e likuiditetit të maturimeve kontraktuale të mbetura të paskontuara në datën e raportimit të grupuara sipas maturimeve të pritshme të pasurive dhe detyrimeve financiare. Shumat e shpalosura në pjesën e parë të tabelës janë flukse monetare kontraktuale të skontuara, ndërsa Banka menaxhon riskun e pandarë të likuiditetit në një bazë të pritshme, bazuar në hyrjet e pritshme të skontuara të parasë së gatshme dhe daljet e raportuara në pjesën e dytë.

Banka synon të ruajë hendekun kumulativ të maturimit pozitiv gjatë gjithë kohës. Nëse hendeku i maturitetit të maturuar pritet të jetë negativ, jo pozitiv, Banka e konsideron likuiditetin si një "pozicion të likuiditetit në vëzhgim".

Shifrat e raportuara në mjetin raportues më poshtë nuk përputhen me pasqyrën e shifrave të pozicionit financiar, që është për shkak të faktit se përveç pozicioneve në bilanc, Banka ka marrë në konsideratë edhe pozicionet jashtë bilancit. Të gjitha asetet dhe detyrimet financiare raportohen në bazë të kohës kur detyrimet (duke përfshirë detyrimet e kushtëzuara nga garancitë e Bankës dhe letrat e kreditit dhe angazhimet e tjera të lidhura me kredinë) bëhen të detyrueshme dhe asetet mund të përdoren si burim shlyerjeje (duke përfshirë zërat jashtë bilancit si pashfrytëzuar të parevokueshme dhe angazhime të pakushtëzuara të kredisë të cilat Banka mund të përdorë si burim likuiditeti në çdo kohë pa miratimin paraprak).

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)
(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2021

Pasuritë

	1 – 30 ditë	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vjet	Me maturitet të pacakutuar	Gjithsej
Paraja në arkë dhe në bankë	12,051,084	-	-	-	-	-	-	12,051,084
Balanca me BQK	7,065,869	-	-	-	-	-	-	7,065,869
Kreditë për klientë	247,531	64,335	-	21,688,914	26,487,445	17,025,918	-	65,514,143
Investimet në letrat me vlerë	-	251,429	1,140,865	249,931	5,361,761	-	-	7,003,986
Pasuritë tjera	252,113	-	-	-	-	-	-	252,113
Gjithsej	19,616,597	315,764	1,140,865	21,938,846	31,849,205	17,025,918	-	91,887,195

Detyrimet

Detyrimet ndaj klientëve	21,128,628	-	24,604,900	24,011,333	125,332	-	-	69,870,193
Detyrimet ndaj bankave	-	-	-	3,731,811	302,559	-	-	4,034,370
Borxhi i varur	4,509,738	-	-	5,035,000	-	-	-	9,544,738
Detyrimet tjera	58,301	41,935	-	18,047	-	-	-	118,283
Detyrimet e qiramarrjes	-	-	-	119,481	407,338	260,037	-	786,856
Gjithsej	25,696,667	41,935	24,604,900	32,915,672	835,229	260,037	-	84,354,440
Hendeku i likuiditetit	(6,080,070)	273,829	(23,464,035)	(10,976,827)	31,013,977	16,765,881	-	7,532,755
Hendeku kumulativ	(6,080,070)	(5,806,241)	(29,270,276)	(40,247,103)	(9,233,126)	7,532,755	7,532,755	-

TURKIYE CUMHURİYETİ ZIRAAT BANKASI A.Ş. – DEGA E KOSOVËS
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)
(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2020	1 – 30 ditë	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vjet	Me maturitet të pacakutuar	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja në arkë dhe në bankë	1,873,383	-	-	-	-	-	-	1,873,383
Balanca me BQK	8,097,791	-	-	-	-	-	-	8,097,791
Kreditë për klientë	-	9,888	166,135	15,848,297	20,136,042	20,330,730	-	56,491,092
Investimet në letrat me vlerë	-	-	-	-	6,857,819	-	-	6,857,819
Pasuritë tjera	283,608	-	-	-	-	-	-	283,608
Gjithsej	10,254,782	9,888	166,135	15,848,297	26,993,861	20,330,730	-	73,603,693
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve	16,006,233	-	26,493,166	15,858,621	125,432	-	-	58,483,452
Detyrimet ndaj bankave	-	-	-	2,071,566	388,090	-	-	2,459,655
Borxhi i varur	4,552,724	-	-	-	-	-	-	4,552,724
Detyrimet tjera	49,216	54,713	-	8,476	-	-	-	112,405
Gjithsej	20,608,173	54,713	26,493,166	17,938,663	513,521	-	-	65,608,236
Hendeku i likuiditetit	(10,353,391)	(44,825)	(26,327,031)	(2,090,366)	26,480,340	20,330,730	-	7,995,457
Hendeku kumulativ	(10,353,391)	(10,398,216)	(36,725,247)	(38,815,613)	(12,335,273)	7,995,457	7,995,457	-

(Shumat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

